

REPUBLIKA E SHQIPËRSIË  
DHOMA E NOTERËVE TIRANË

NR. 3398 REP.

NR. 1746 COL. 12



MARRËVESHJE BASHKIMI ME PËRTHITHJE

Sot, më 26/08 2020, në Tiranë, përpara meje, [Signature], Noter i Dhomës së Noterëve Tiranë, paraqiten personat e mëposhtëm:

- Shoqëria SERE SH.P.K., person juridik që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me seli në Njesine Bashkiake Nr. 2, Rr. "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3, kati 8, Ap. Nr. 3 dhe 4, Tiranë, e regjistruar në Regjistrimin Tregtar me datë 22/08/2012, me NUIS L22022002F, me kapital të regjistruar me vlerë 152,000 LEKE përfaqësuar nga Administratori i saj Zj. Vjola Kambellari, në cilësinë e Administratorit të Vetëm dhe përfaqësuesit ligjor të shoqërisë;
- Shoqëria BFI INVEST SH.P.K., person juridik që vepron në përputhje me legjislacionin në fuqi në Republikën e Shqipërisë, me seli në rrugën Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA, Business Center Tiranë, e regjistruar në Regjistrimin Tregtar me datë 21/05/2015 me NUIS L51721007Q, me kapital të regjistruar me vlerë 5,000,000 LEKE, përfaqësuar nga Administratori i saj Zj. Ardiana Sokoli, në cilësinë e Administratorit të Vetëm dhe përfaqësuesit ligjor të shoqërisë;

Personat e paraqitur, për identitetin e të cilëve unë Noteri jam e sigurt, bien dakord për sa parashikuar në vijim nga ky akt

**duke parashtruar se :**

- BFI INVEST SH.P.K. zotëron 100% të kapitali themeltar të shoqërisë SERE SH.P.K.;
- projekt marrëveshja e bashkimit të shoqërive SERE SH.P.K. dhe BFI INVEST SH.P.K. është regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit me datë 17 Korrik 2020 dhe numër ështëjeje CN- CN-545708-0720-07-20;
- me datë 24.08.2020, shoqëritë SERE SH.P.K. dhe BFI INVEST SH.P.K., me vendimet respektive të asamblesë së përgjithshme sikurse më sipërshënuar, kanë aprovuar bashkimin nëpërmjet përthithjes së shoqërive BFI INVEST SH.P.K. (në vijim "shoqëria e përthithur") nga shoqëria SERE SH.P.K. (në vijim "shoqëria përthithëse"), duke miratuar, ndër të tjera, edhe projektin e bashkimit të publikuar dhe regjistruar në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi; dhe
- tashmë, sipas nenit 216, paragrafi 3, dhe nenit 225, paragrafi 2, Ligjit nr. 9901, me datë 14.04.2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (në vijim "Ligji Tregtar"), është e mundur të

[Signature]

[Signature]

procedohet me ekzekutimin e marrëveshjes së bashkimit.



**Duke u mbështetur në këto kushte që konsiderohen pjesë thelbësore dhe integrale të këtij akti palët bien dakord për sa më poshtë:**

- 1) Shoqëritë SERE SH.P.K. dhe BFI INVEST SH.P.K., deklarohen dhe konsiderohen të bashkuara nëpërmjet përthithjes së shoqërive BFI INVEST. nga shoqëria SERE SH.P.K. mbi bazën e vendimeve respektive të asamblesë së përgjithshme me datë 24.08.2020.
- 2) Rrjedhimisht, duke u mbështetur në sa më sipër, shoqëria SERE SH.P.K. zëvendëson me të drejta të plota shoqërinë BFI INVEST SH.P.K. në pasurinë e tyre aktive dhe pasive, si dhe në të gjitha pretendimet, çështjet gjyqësore, të drejtat, kontratat, detyrimet dhe debitë e cilësdo natyre qofshin, duke marrë përsipër të shlyejë dhe shuajë të gjitha debitë eventualisht ekzistuese brenda afateve përkatëse; dhe, me anë të këtij akti, autorizohet çdo ent apo organ tjetër kompetent i administratës publike, person juridik publik apo privat, pa qene e nevojshme kryerja e formaliteteve të mëtejshme, që të transferojnë dhe të zëvendësojë titullaritetin e të mirave (duke kryer kthimet dhe transkriptimet eventualisht të kërkuara për këtë qëllim) dhe vendosjen e tyre në emër të shoqërisë SERE SH.P.K., autorizohet gjithashtu kalimi i çdo pasurie të luajtshme apo të paluajtshme, akti, dokumenti, garancie, police, licence, lejeje dhe kontrate e cilësdo natyre qoftë, llogari aktive apo pasive në emër të shoqërive të përthithura, duke i shkarkuar këto subjekte nga çdo përgjegjësi e pa qenë e nevojshëm të lëshohen autorizime apo të kryen formalitete të mëtejshme.
- 3) Me ekzekutimin e bashkimit të shoqërive në fjalë, gjejnë zbatim të plotë vendimet e asambleve përkatëse miratuar me datë 24.08.2020.
- 4) Në veçanti, sikurse rezulton nga projekt marrëveshja e bashkimit dhe vendimet e asambleve përkatëse, duke qenë se bëhet fjalë për një formë të tërthortë bashkimi:
  - a. nuk do të ketë ndryshime në statutit të shoqërisë përthithëse;
  - b. kapitalit i shoqërisë përthithëse do të zmadhohet në vlerën 5,000,000 Lekë ;
  - c. nuk është përcaktuar raporti i këmbimit të kuotave;
  - d. kuota e shoqërisë përthithëse SERE SH.P.K. nuk do të shpërndahen (caktohen) në një mënyrë të ndryshme, ndërsa kuotat që përbëjnë kapitalin themeltar të shoqërisë së përthithura BFI INVEST SH.P.K. të zotëruara tërësisht nga ortaku i vetem shoqëria përthithëse, do të anulohen.
- 5) Data nga e cila marrëveshja e bashkimit shpallor efektet e saj dhe hedhja operacioneve të shoqërive të përthithura në bilancin e shoqërisë përthithëse përcaktohet sipas parashikimeve të nenit 220, paragrafi 1 dhe 3 të Ligjit Tregtar. Pra, efektet e bashkimit në raport me kalimin e aktiveve dhe pasive të shoqërive të përthithura hyjnë në fuqi nga data e kryerjes së regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Ndërsa, për qëllime kontabël dhe fiskale efektet e bashkimit rrjedhin nga data 1 maj 2020, si edhe përcaktuar në projekt marrëveshjen e bashkimit.

6) Pushojnë së bashku organet e shoqërisë BFI INVEST SH.P.K. dhe të gjitha prokurat eventuale lëshuar në emër dhe për llogari të tyre, ndërsa organi administrativ i shoqërisë përthithëse do të qëndrojë në detyrë deri në përfundimin e afatit të caktuar.

7) Shoqëria e përthithura BFI INVEST SH.P.K., autorizojnë në mënyrë të pakthyeshme shoqërinë përthithëse SERE SH.P.K. të kryejë çdo veprim, procedurë apo formalitet të nevojshëm dhe oportun me qëllim njohjen e saj si titullare ekskluzive të çdo aktiviteti ekonomik të shoqërisë së përthithur dhe ta zëvendësojë atë me te drejta e plota në çdo raport aktiv dhe pasiv të krijuar prej tyre.

8) Pavarësisht nga sa më sipër, SERE SH.P.K. nëpërmjet përfaqësuesit të saj ligjorë merr përsipër t'i japë çdo kreditori eventual që ngre pretendime, brenda afateve të përcaktuara në nenin 221 të Ligjit Tregtar, të gjitha garancitë e parashikuara në nenin 221, paragrafi 1, Ligjit Tregtar.

\*\*\*\*

Kjo Marrëveshje, pasi u hartua prej meje, Noteres, iu lexua palëve të cilat e kuptuan, aprovuan dhe e deklaruan atë në përputhje me vullnetin e tyre. Marrëveshja u nënshkrua lirisht nga palët në praninë time dhe unë, Noteri, e vërtetoj atë sipas ligjit.

SERE SH.P.K.

Viola Kambellari - Administratori i Vetëm



BFI INVEST SH.P.K.

Ardiana Sokoli - Administratori i Vetëm

BFI INVESTI SH.P.K.  
L817210070

NOTER







REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L51721007Q	
2. Data e Regjistrimit	21/05/2015	
3. Emri i Subjektit	"BFI Invest"	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	18/05/2015	
6. Kohëzgjatja	Nga: 18/05/2015	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Rruga Papa Gjon Pali II, Kati 11, ABA, Business Center	
8. Kapitali	5.000.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	1,00	
9. Objekti i aktivitetit	Investime per pasuri te paluajtshme, tregtim i artikujve te ndryshem, sherbime konsulence, ne fushen e biznesit, menaxhimit, taksave etj. Importi, eksporti, shitja me shumice dhe pakice e produkteve tekstile, veshjeve te te gjitha llojeve. Shitja me shumice dhe pakice e mallrave industriale dhe ushqimore. Importi , eksporti, shitja me shumice dhe pakice e pajisjeve elektrike, elektronike, lende te pare per industrine, materiale ndertimi e hidrosanitare, pajisje zyresh, kancelari, pjese kembimi auto e makineri te çdo lloji, pajisje teknologjike;. Shitja, blerja, dhenia me qira, e pasurive te paluajtshme. Transport i mallrave dhe udhetareve brenda dhe jashte vendit. Menaxhimin i qendrave tregtare, bareve, restoranteve. Si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike qe do te konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e qellimit te Shoqerise e qe nuk bie ndesh me legjislacionin shqiptar ne fuqi.	
10. Administratori/ët	Ardiana Sokoli	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 15/01/2018	Deri: 15/01/2023
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT



parashikimet ligjore 11.1 Kufizimet e kompetencave (nëse ka)	Administratori/et mund të emerojë/ne përfaqesues me prokurë speciale ("ad negotia") për kryerjen e një akti ose kategori aktesh në kufijte e tagrave që u janë dhënë atyre nga ligji në fuqi ose ky Statut Miratimi i kërkesave të reja dhe rinovimi i kërkesave ekzistuese për financim deri në vlerën e barabartë me 500,000 EUR (peseqind mijë Euro), mbi këtë vlerë miratimi i kërkesave të reja dhe rinovimi i kërkesave ekzistuese për financim do të kryhet vetëm me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë; Miratimi i blerjeve, shitjeve, nënshkrimit të kontratave me pale të treta për punë, shërbime apo çdo lloj marrëdhënie tjeter deri në vlerën e barabartë me 500,000 EUR (peseqind mijë Euro), mbi këtë vlerë do të merret miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë; investimet dhe shpenzimet e paparashikuara në buxherin vjetor të Shoqërisë deri në vlerën e barabartë me 100,000 EUR (njëqind mijë Euro).	
12. Ortakët	BALFIN	
12.1 Vlera e kapitalit	Para: 5.000.000,00	Natyre:
12.2 Numri i pjesëve	1,00	
12.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
12.4 Komentë (nëse ka)		
13. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit		
14. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: "BFI Invest" E-Mail: e.prendi@manetci.al Telefon: 042389250	
15. Statusi:	Aktiv	

Datë: 26/08/2020

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)



REPUBLIKA E SHQIPËRISË / REPUBLIC OF ALBANIA



mbiemri/surname

**Sokoli**

emri/given name

**Ardiana**

shqetësia/nationality

**Shqiptare/Albanian**

vendlindja/place of birth

**Shkodër**

datelindja/date of birth

**20-01-1970**

data e tërësimit/date of issue

**19-08-2014**

autoriteti iëshues/authority

**MB**

nr. letërnjoftim/card no.

**032599583**

gjinia/sex

**F**

data e skadimit/date of expiry

**18-08-2024**

nr. personal/personal no.

**H05120262G**

ALF  
NOTA  
MILAN






REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

## EKSTRAKT I REGJISTRIT TREGTAR PËR TË DHËNAT E SUBJEKTIT "SHOQËRI ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR"

### GJENDJA E REGJISTRIMIT

1. Numri unik i identifikimit te subjektit (NUIS)	L22022002F	
2. Data e Regjistrimit	22/08/2012	
3. Emri i Subjektit	SINGAPORE EUROPE REAL ESTATE (S.E.R.E)	
4. Forma ligjore	SHPK	
5. Data e themelimit	08/08/2012	
6. Kohëzgjatja	Nga: 08/08/2012	
7. Zyra qendrore e shoqërisë në Shqipëri	Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr. 2, Rruga "Dervish Hima", Pallati Ambasador 3 , kati 8~te, Ap. nr. 3 dhe 4	
8. Kapitali	152.000,00	
8.1 Numri i përgjithshëm i kuotave	100,00	
9. Objekti i aktivitetit	Investime per pasuri te paluajtshme, import-eksport, tregtim i artikujve te ndryshem, sherbime konsulence, ne fushen e biznesit, menaxhimit, taksave etj.	
10. Administratori/ët	Vjola Kambellari	
10.1 Afati i emërimit	Nga: 21/11/2016	Deri: 21/11/2021
11. Procedura e emërimit nëse ndryshon nga parashikimet ligjore		
11.1 Kufizimet e kompeteneave (nëse ka)		
12. Eksperti/ët Kontabël (nëse ka)	Ernest Dega e Shoqerise se Huaj	
12.1 Afati i emërimit	Nga: 24/07/2020	Deri:
13. Ortakët	"BFI Invest"	
13.1 Vlera e kapitalit	Para: 152.000,00	Natyre:
13.2 Numri i pjesëve	100,00	
13.3 Pjesëmarrja në përqindje (%)	100,00	
13.4 Komente (nëse ka)		



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
QENDRA KOMBËTARE E BIZNESIT

14. Vende të tjera të ushtrimit të aktivitetit	
15. Të dhëna që njoftohen vullnetarisht	Emri Tregtar: S.E.R.E. E-Mail: v.kambellari@sere.al Telefon: 0698020609
16. Statusi:	Aktiv

Datë: 26/08/2020

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi  
(i nëpunësit të sportelit)

Kopje nga MEB

TRIP  
MONTANA

TRIP  
MONTANA

TRIP  
MONTANA



